

Njoftim për përqendrim me të cilin PERUTNINA PTUJ d.o.o., Republika e Sllovenisë dhe Familja Nitsiakos nga Greqia do të fitojnë kontroll të përbashkët ndaj Th. Nitsiakos AVEE Ptinotrofikes Epicheiriseis, Janinë, Greqi

(Lënda nr. 08-97/2026)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 05.06.2026, ndërsa i plotësuar më datë 09.06.2026, pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin **PERUTNINA PTUJ d.o.o.** (PERUTNINA PTUJ d.o.o.), me seli të regjistruar në Potrçeva cesta nr. 10, 2250 Ptuj, Republika e Sllovenisë, dhe **Familja Nitsiakos**, e përbërë nga personat fizikë të vijueshëm, të cilët veprojnë bashkërisht si persona me kontroll përfundimtar: z. Konstantinos Nitsiakos, banor i Greqisë, znj. Angeliki Nitsiakou, banore e Greqisë, dhe znj. Eleni Nitsiakou, banore e Greqisë, të cilët veprojnë së bashku përmes subjekteve të vijueshme nën kontroll: ISTOS TOXOTIS SHOQËRI E THEMELUAR NGA NJË PERSON me seli të regjistruar në rr. Merlin nr. 7, Athinë 106 71, Greqi; ORITEN MELORIA SHOQËRI E THEMELUAR NGA NJË PERSON, me seli të regjistruar në rr. Merlin nr. 7, Athinë 106 71, Greqi; MPE MARITE SHOQËRI E THEMELUAR NGA NJË PERSON, me seli të regjistruar në rr. Merlin nr. 7, Athinë 106 71, Greqi; ISTOS TOXOTIS Ltd., me seli të regjistruar në rr. Prespas nr. 2, kati 3, banesa 302, Agio Omolgitas, 1082 Nikozia, Qipro; ORITEN MELORIA LIMITED, me seli të regjistruar në rr. Levantas nr. 19, Mesa Geitonia, 4007 Limasol, Qipro; MPE MARITE Ltd., me seli të regjistruar në rr. Prodromou nr. 65, kati 7, banesa 702, 2062 Nikozia, Qipro, synojnë të fitojnë kontroll të përbashkët ndaj **Th. Nitsiakos AVEE Ptinotrofikes Epicheiriseis** (Th. Nitsiakos AVEE Ptinotrofikes Epicheiriseis), me sedi të regjistruar në Zonën Industriale të Janinës, Rodotopi, 45500 Janinë, Greqi.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

PERUTNINA PTUJ d.o.o. është shoqëri në pronësi të plotë të MHP SE (MHP SE), shoqëri e themeluar dhe ekzistuese në përputhje me ligjet e Qipros, me seli në rrugën Zinas Kanther 16-18, Ayia Triada, 3035 Limasol, Qipro.

Grupi MHP ka në pronësi një shoqëri të regjistruar në Maqedoninë e Veriut:

Shoqëria për tregti me shumicë me mish dhe produkte mishi PERUTNINA PTUJ SHPKNJP Shkup, me veprimtari të regjistruar: 46.320 – Tregti me shumicë me mish, produkte mishi, peshk dhe produkte peshku, me seli të regjistruar në rr. Stoltenbergova nr. 4, lamela b/hyrja 1-7, majtas, Shkup,

Familja Nitsiakos përfaqëson një njësi të vetme ekonomike të përbërë nga z. Konstantinos Nitsiakos, znj. Angeliki Nitsiakou dhe znj. Eleni Nitsiakou, të cilët kanë ndikim vendimtar dhe kontroll mbi shoqëritë blerëse Nitsiakos, në përputhje me të drejtat e tyre të pronësisë dhe menaxhimit. Shoqëritë blerëse Nitsiakos nuk ushtrojnë asnjë lloj aktiviteti afarist, përveçse veprojnë si subjekte holding për Shoqërinë e Synuar.

Subjektet nën kontrollin e Familjes Nitsiakos nuk kanë prani në Maqedoninë e Veriut dhe, me përjashtim të Th. Nitsiakos AVEE Ptinotrofikes Epicheiriseis, nuk kanë realizuar asnjë lloj të ardhure në Maqedoninë e Veriut në vitin 2025.

Në nivel global, **Th. Nitsiakos AVEE Ptinotrofikes Epicheiriseis** është një grup grek i mishit dhe shpendëve, aktiv në të gjithë zinxhirin e furnizimit me shpendë, përfshirë rritjen e shpendëve, therjen dhe përpunimin e mishit të freskët dhe të ngrirë të pulës. Gjithashtu, kryen furnizimin me zogj dhe vezë për rritje dhe është aktiv në prodhimin e ushqimit për kafshë (përfshirë shpendët dhe blegtorinë) si dhe ushqimit për kafshët shtëpiake.

Në Maqedoninë e Veriut në vitin 2025, grupi Nitsiakos ka vepruar me një gamë të gjerë kategorish të produkteve. Parimisht ka qenë aktiv në shitjen e produkteve nga kulturat vajore, si dhe të mishit të papërpunuar të shpendëve (të freskët dhe të ngrirë), dhe ushqimit për kafshët shtëpiake. Grupi i synuar nuk vepron përmes ndonjë subjekti vartës ose dege të regjistruar lokalisht në Maqedoninë e Veriut.

Duke pasur parasysh aktivitetet afariste të **Th. Nitsiakos AVEE Ptinotrofikes Epicheiriseis** në Maqedoninë e Veriut, e veçanërisht tregun në të cilin Pjesëmarrësit mbivendosen horizontalisht në Maqedoninë e Veriut, sipas parashtruesve të njoftimit, ***tregu përkatës për përqendrimin në fjalë mund të definohet si tregu për shitjen me shumicë të mishit të shpendëve, kurse tregu gjeografik si territori i Republikës së Maqedonisë së Veriut.***

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar lidhur me këtë çështje mbetet i rezervuar.

Komisioni i fton palët e treta të interesuara që t'i dorëzojnë vërejtjet dhe mendimet e tyre lidhur me këtë përqendrim Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. „Shën Kirili dhe Metodi“ nr. 54, Shkup, ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk, dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda afatit prej 10 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

11.06.2026

Shkup